



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY  
RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Njomza Hoti – Krasniqi – Exp teknik	19.04.2022	29.04.2022
Visar Bibaj – Exp Shqyrtues		
Nënshkrimi i eksperteve	data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

**N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit**

Me datën: 12.04.2022, OE "Albo Group" sh.p.k - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull :“**Analiza e fizibilitetit te parkut industrial**”, me numër të prokurimit: **615-25-2434-2-3-6**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna - Podujevë**.

**Ankesa nuk është e përsëritur.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankes.

**Operatori Ekonomik Ankues: "Albo Group" sh.p.k – Prishtinë**

Dispozitat e shkelura të LPP-së, sipas OE ankues: "**Albo Group**" sh.p.k janë:

- Neni 1 i LPP-se
- Neni 7 i LPP-se
- Neni 59 i LPP-se
- Neni 60 i LPP-se

**DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:**

Të nderuar PAS publikimit të njoftimit për kontratë, kemi vërejtur se kushtet e tenderi janë diskriminues, kufizues me përjashtim të një OE sepse të kërkosh referenca strikte vetëm të studimit të fizibilitetit kur dihet se projektet e tjera janë shumë më të komplikuar dhe më të rëndësishme e mos me vlej të referencat e strategjive.

Studime të fizibilitetit janë bërë shumë pak në Republikën e Kosovës, ku edhe nuk ka kompani që kanë bërë vetëm punë të tilla.

Ne kemi kërkuar sqarime ku AK shkruan:

Raporti i ekspertit teknik, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Albo Group" sh.p.k – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Analiza e fizibilitetit te parkut industrial", me numër të prokurimit: 615 22 2434 236, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK - Podujevë.

**1. Kontratat të ngjashme a i nënkuptoni edhe strategji të zhvillimit ekonomik/ plane dhe programe të ndryshme zhvillimore apo vetëm studime fizibiliteti?**

**Sqarim:**

Kontratat e ngjashme nënkuptohen të natyrës së ngjashme të studimeve të fizibiliteteve të të çdo lloj natyre apo lëmie të ndryshme që kanë të bëjnë me studime të fizibilitetit.

**Kriteret për vlerësim:**

**III.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:**

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, në vlerë minimale prej 10,000.00 Euro, në 3 (tre) vitet e fundit
2. Një ekonomist i diplomuar ose master i ekonomisë, me përvojë pune minimumi 2 vite pas diplomimit.

**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 4 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve.
2. Lista e stafit profesional së bashku me diplomat, CV-të, kontratat e punës ose marrëveshja për bashkëpunim në këtë projekt, dëshmitë mbi përvojën e punës. Për të plotësuar kërkesat duhet të ofrohen edhe këto dëshmi së paku një letër referenca nga punëdhënësi ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme si dhe vendimet e nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania për caktimin në pozitë të kërkuara.

## Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Albo Group" Sh.p.k - Prishtinë

Sqarim Hyres:

Autoriteti Kontraktues – Komuna Podujeve, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedur të hapur, lloji i kontratës është "Kontrate Publike Kornize- Shërbim", - kuotim i çmimit. Pretendimet ankimore kane te bëjnë kundër njoftimit per kontrate, përkatësisht kundër kërkesave te kualifikimit te pershtatshmeris profesionale.

Kunder ketije njoftimi parashtruesi i ankesës te njëjtat kërkesa i ka kontaktuar përmes kërkesës per ri shqyrtim përdërisa AK – Komuna Podujeve, kerkese e ka refuzuar si te pa bazuar, rrjedhimisht pretendimet ankimore ne tërësi janë trajtuar nga eksperti teknik dhe ate si me poshtë:

### PRETENDIMI NR.1

Lidhur me pretendimin e OE drejtuar AK:

Pas publikimit te njoftimit per kontrate, kemi vërtet se kushtet e tenderit janë diskriminues, kufizues me përjashtim te nje OE sepse te kërkosh referenca strikte vetëm te studimit te fizibilitetit kur dihet se projektet e tjera janë shume me te komplikua dhe me te rëndësishme e mos me vlejte referencat e strategjive.

Studime fizibiliteti janë bere shume pak ne Republikën e Kosoves ku edhe nuk ka kompani qe kane bere vetëm pune te tilla.

Sqarimi i juaj bie ndesh edhe me kushtet e dosjes se tenderit.

Në vendimit e shqyrtimit të ankesë në një pargarafë të AK thuhet:

Nuk qëndron fakti dhe nuk eshte e vërtet se nuk ka ne Kosove qe janë bere shume pak studime fizibiliteti dhe nuk ka kompani per studim te fizibilitetit dhe studime tjera, përkundrazi ne Kosove jo qe nuk behen fizibilitete por ka edhe shume kompani qe merren me studime te fizibiliteteteve dhe studime te tjera qe i kane ne veprimtarit e tyre te bizneseve e qe janë te natyrës se ngjashme por jo strikte sic pretendoni, ndërsa ne komunën e Podujeves vitin e kaluar kemi pas projekt dhe eshte realizuar Analiza e fizibilitetit te parkingut nëntokësor, po ashtu edhe vitet tjera paraprake.

Pikrishtë këtu qëndron "lepuri", pse vitin e kaluar nuk është kërkuar referenca për analizë të fizibilitetit te "Parkingut nëntokësor" por po kërkohen tani. A pse e keni një kompani që e ka bërë një studim fizibilitetit dhe ja keni jap një referencë. Kushtet e parkingut nëntokësor ishin:

Pyetje per sqarime shtese nga OE per AK:

1.Kontratat e ngjashme a i nenkuptoni edhe strategji te zhvillimit ekonomik/plane dhe programe te ndryshme apo vetem fizibiliteti ?

Sqarime nga AK :

Kontratat e ngjashme nenkuptohen te natyres se ngjashme te studimeve te fizibiliteteteve te te cdo lloj natyre apo lemie te ndryshme qe kane te bejne me studime te fizibilitetit.

Eksperti teknik per pretendimin nr.1 te OE ankues, sqaron se *AK ne Aneksin 4 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës*

*ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve ka kërkuar dokumentacion duke theksuar “nje liste te kontratave te realizuara” dhe jo te paktën nje kontrate te realizuar (duke favorizuar nje OE sipas pretendimit te ankuesit).*

*Sqarimi i AK lidhur me pretendimin e OE eshte i qarte se ne Kosove behen analiza te fizibilitetit dhe ka marre si shembull “Analizen e fizibilitetit te parkingut nëntokësor” po ashtu edhe vitet tjera paraprake e qe do te thotë se bie ndesh me pretendimin e OE se “ Studime fizibiliteti janë bere shume pak ne Republiken e Kosoves ku edhe nuk ka kompani qe kane bere vetëm pune te tilla.”*

*Prandaj bazuar ne dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues nuk qëndron i bazuar.*

### **Mendimi i ekspertit teknik**

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Albo Group" sh.p.k - Prishtinë, të refuzohet si e pa bazuar (për arsyetimet që u cekën në pretendimin e lartëshënuar), propozojmë Autoriteti Kontraktues, Komuna se Podujeves” te vazhdoj me procedurat e prokurimit sipas LPP-se.